



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Numri i Ceshtjes : 71041-02487-11-2019
Numri i Vendimit: 11-2019-5733

Data e Regjistrimit : 02/10/2019
Data e Vendimit : 14/10/2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Eda Kaja
SEKRETARE: Mimoza Cani

Sot më datë 14/10/2019 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :
Kërkues SHL sh.p.k

Objekti: Kerkoj Heqjen e sekuestres preventive vendosur me vendimin nr. 135 date 20.03.2017 te dhene nga Gjykata e Rrethit Gjyqsore Dunes, mbi objektin " Komleks banimi dhe sherbimi, Hoteleri, 2 kat nen toke + I kate sherbimi +2 kat hotel +1 kat sherbim 11 kate banimi+2 kate hotel +2 kate sherbim + Skybar dupleks", qe nodhet ne veildin e qtajtur Shkemb i Kavajes , L Nr. 13 , Njesia Administrative Rrashbull, Dunes.

Baza Ligjore: Nenet ,274 e vijues te K.Pr.P

Përfaqesuesi i kërkuesit **av Rexh Margjeka**, kërkoi:

- Heqjen e masës së sekuestros së vendosur me vendimin e Gjykatës së rrethit Gjyqësor Durrës Nr 135, date 20.03.2019.

Prokurori Afrim Shehu, kërkoi:

- Rrëzimin e kërkesës.

VEREN :

F a q j a l n g a 4

Vëren:

Se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës po kryhen hetime për veprat penale të "Shpërdorimi i detyrës" dhe të "Prodhimi e mbajta pa leje të armëve luftarake e municioneve", që parashikohen nga nenet 248 dhe 278/2 të Kodit Penal dhe ka rezultuar se:

Më datë 17.02.2017, Policia Gjyqësore Durrës është njoftuar se në vendin e quajtur "Shkëmbi i Kavajës", Lagja Nr. 13, Plazh, Durrës, ishin shembur 3 katet e sipërme të objektit shumë katësh në pronësi të shtetasit E.SH. Është kryer këqyrja e vendit të ngjarjes të objektit që ishte shembur. Ky objekt sipas lejes së ndërtimit me Nr. 03, të datës 06.10.2014, dhe

Nr. 6, datë 24.12.2005 e Nr. 1, datë 21.04.2006, është Kompleks Shërbimi-Hoteleri-Banimi 12 kate+papafingo+2 kat nën tokë, të lëshuara nga K.R.R.T e Komunës Rrashbull, sot Njësia Administrative Rrashbull.

Rezulton se K.R.R.T. Rrashbull, lejen e ndërtimit të miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 21.04.2006, nuk e ka pasur të zbardhur dhe investitori "ER" (SHL.) sh.p.k. ka ndjekur rrugën gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës që me Vendimin Nr. 1383, datë 18.05.2012 ka vendosur:

-Të pranojë pjesërisht kërkesë-padinë e paditësit "SH.L-CO" sh.p.k. me të paditur K.R.R.T e Komunës Rrashbull dhe Zyra e Urbanistikës e person të tretë INUV pranë Komunës Rrashbull.

-Të shpallë të falsifikuar shkresën me shtatë faqe, Vendimi Nr. 1, datë 21.04.2016, të paraqitur në gjykim nga përfaqësuesi i palës së paditur Komuna Rrashbull ku në faqen 63 pika 17 shkruhet "Nuk miratohet kërkesa ER sh.p.k. për rishqyrtim leje shesh ndërtimi dhe leje ndërtimi mbi objektin kompleks shërbimi-hoteleri- banim", një kopje e vendimit t'i kalojë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

-Të detyrojë palën e paditur Zyra e Urbanistikës në Komunën Rrashbull, që të zbardh lejen e ndërtimit të miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 21.04.2016, në favor të Shoqërisë "ER" sh.p.k., sot "SH.L-CO" sh.p.k.

-Të detyrojë palën e paditur Komuna Rrashbull që të nxjerr aktin administrativ "Leje ndërtimi" në favor të Shoqërisë "Shala -E-CO" sh.p.k. për katet shtesë në lartësi dhe shtesën anësore si më poshtë: shtesë anësore (ballore) me sipërfaqe 500 m²x4 kt, gjithsej 2000 m².

-Shtesë kati në lartësi-3 kt, shërbimi me sipërfaqe 2080,5 m²x3=6241,5 m² (kati zero + kati i I + kati i II)-kt-Hotel (kati me sipërfaqe 1510 m²x2=3020m²) + 2 kt shërbimi me sipërfaqe 1689 m²x2=3.396 m² +skybar dublet, me sipërfaqe 530 m²x2=1060 m² (ish papafingo e miratuar më parë).

-Të detyrojë Zyrën e Urbanistikës Komuna Rrashbull për të nxjerrë aktin administrativ leje shfrytëzimi për objektin e përfunduar të paditësit në tërësi.

Bazuar në aktet e mësipërme nga Shoqëria "Universal Engineering" sh.p.k. është përpiluar akti i kolaudit me 29 fletë, pa datë, por që është njësuar me origjinalin më datë 23.06.2015 nga shtetasi E.SH dhe më pas nga lëshimi i Certifikatës së Përdorimit me Nr.

1607/1 (datë s'ka) Qershor 2015, sipas të cilës lejohet përdorimi i objektit ndërtimor "Kompleks banimi dhe shërbimi, Hoteleri 2 kate nën tokë+ 1 kat shërbimi+ 2 kate Hotel + 1 Kat shërbim + 11 kate banimi + 2 kate Hotel + 2 kate shërbimi + Skybar dupleks, pranë Njesisë Administrative Rrashbull, Durrës.

Ne kuader te ketij hetimi me vendimin nr 135 date 20.03.2017, është vendosur:

1. Pranimin e kërkesës të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

2. Vendosjen e masës së sigurimit sekuestro preventive mbi objektin "Kompleks banimi dhe shërbimi, Hoteleri:2 kate nën tokë+1 kat shërbimi+2 kate Hotel+1 kat shërbimi+11 kate banimi+2 kate hotel+2 kate shërbim+ Skybar dupleks" që ndodhet në vendin e quajtur

Shkëmbi Kavajës, Lagja Nr.13, Njësia Administrative Rrashbull, Durrës.

Nga ana e kerkuesit Shoqëria "SHL" sh.p.k, me datë 02.10.2019, është paraqitur në Gjykatë kërkesa me objekt: heqje sekuestro

te vene me vendim Nr 135 date 20.03.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

Gjykata pasi shqyrtoi me kujdes të gjithë materialet e çështjes çmon se:

Vendimi për vënien e sekuestros preventive duhet të ndryshohet dhe masa e sekuestros dhene me vendimin nr 135 date

20.03.2017, duhet të hiqet ,pasi provohet se objekti për të cilin është vene sekuestro është ndërtuar sipas lejeve të ndërtimit të

lëshuara nga KRRR-tja e Komunës Rrashbull, me nr.06, date 24.12.2005 , nr. 01, date 21.04.2006, dhe nr. 03, date 06.10.2014 si

dhe sipas vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor nr. 11-2012-4216, date 18.05.2012 që kanë pranuar padin e subjektit

``SHALA –E-CO`` shpk ish ``ER`` shpk, për detyrimin e pales paditur Komuna Rreshbull dhe Zyren e Urbanistikes , të

nxjerrin aktin administrative ``leje ndertimi `` në favor të Shoqerise ``SHALA –E-CO`` shpk dhe zbardhjen e kesaj leje, (pasi organi

administrative Komuna Rrashbull, nuk shprehej në afatin ligjor për miratimin e kerkesave të ligjshme të subjektit). për ndertimin e

objektit ``Kompleks sherbimi, Hoteleri-Banimi 11, 12 Kat + papafingo + 2 kat nën toke, pra nuk mund të vihet sekuestro preventive

për një objekt që është me leje ndertimi, në sherbim të procedimit penal, për veprën penale të ``Shpërdorimit të detyres`` dhe

të ``Prodhimit dhe mbajtjes pa leje e armeve luftarake dhe municionit`` parashikuar nga nenet 248, 278/2 K.Penal, pasi sekuestro

është vene për të ndihmuar procedimet penale nr. 308, date 23.02.2017, nr. 333, date 27.02.2017 ku me pas janë bashkuar në

një procedim të vetëm. Referuar, si kerkeses për vënien e sekuestros dhe vendimit të gjykatës që ka miratuar sekuestron, kjo

sekuestro është vene për keto dy procedime . Pra në kete rast sendi (objekti i ndertimit në pronesi të shoqerise ``SHALA-ECO``

shpk) nuk ka lidhje me veprat penale të ``Shpërdorimit të detyres`` apo ``Prodhimit dhe mbajtjes pa leje e armeve luftarake

dhe municionit`` mbi të cilat është vene kjo sekuestro.

Gjykata me vendimin nr 135 datë 20.03.2017, nuk ka vene sekuestro për pjesën e ndertimit që subjekti fizik dhe jo shoqeria ka

aplikuar për legalizim për një shtesë të objektit, por ka vendosur sekuestro për pjesën e ndertimit që është me leje ndertimi.

Gjithashtu me kete vendim nuk është vendosur sekuestro bazuar në veprën penale të ``Ndertimit të paligjshëm`` për të cilën

prokurori i është drejtuar gjykatës me kerkesë për dërgim ceshtje në gjygj për palen kerkuese pra për shoqerine Shala e&Co por për

veprat penale të ``Shpërdorimit të detyres`` dhe ``Prodhimit dhe mbajtjes pa leje e armeve luftarake dhe municionit`` për të cilat

objekti nuk mund të sekuestrohet referuar nenit 274 KPrP. Rezulton se në kohën që është vene kjo sekuestro po hetohet

Faqja 2 nga 4

vetëm për keto dy akuza dhe jo për ``Ndertim të paligjshëm``, prandaj vendimi i gjykatës nr 135 datë 20.03.2017 nuk mund të

vendoste për fakte të cilat nuk dihet nëse do të ndodhin në të ardhmen ose jo, por duhet të vendoste vetëm për fakte që kanë

ndodhur.

Në respektim të ligjit procedural të parimit të vënies së drejtësisë nga ana e gjykatës, të parimit të respektimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të

drejtave të njeriut, të parimit të mbrojtjes së drejtës së pronës dhe sipërmarrjes private pala kërkuese e interesuar dhe e dëmtuar cmon se
kërkesa për heqjen e sekuestros preventive e vendosur nga vendimi me nr 135 datë 20.03.2017 është legjitime dhe në respektim të disponimit të lirë dhe përdorimit sa më eficient të pronës.

Vazhdimi i sekuestros preventive mbi pasuritë e fituara në mënyrë të ligjshme bie në kundërshtim me nenin 1 të Protokollit Shtesë të K.E.D.NJ, nenet 41,42 dhe 142/1 të Kushtetutës, dhe nenin 274 të K.Pr Penale duke cënuar në thelb lirinë dhe të drejtën e posedimit dhe disponimit të lirë të pronës dhe sipërmarrjes private për Shoqërinë "SHL" sh.p.k, dhe duke sjell pasoja të mëdha ekonomike për shoqërinë duke e bllokuar aktivitetin i cili e ushtron në mënyrë të ligjshme.

Vazhdimi i "Sekuestros Preventive" mbi pasuritë e shoqërisë Shoqëria "SHL" sh.p.k të vendosur në vendimin me Nr. 135 datë

20.03.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës i ka shkaktuar shoqërisë dëm të madh ekonomik, provuar këto me provat që pala kërkuese ka paraqitur në këtë gjykim.

Gjykata cmon se *"Kërkesa për heqje sekuestro preventive mbi pasurite e shoqërisë nr 135 datë 20.03.2017, është legjitime referuar dhe nenit 274 paragrafi 3 i K.Pr.Penale pasi:*

Sendi i sekuestruar nuk është produkt i ndonje veprë penale, pasi është ndertuar me leje ndertimi, dhe për këtë objekt është leshuar certifikata e përdorimit nga organi teknik, ky objekt është pjesë e qarkullimit civil. Për pjesën me të madhe të këtij objekti janë bërë transaksione duke u shitur tek personat të tretë dhe kanë kaluar në pronësi të pronarëve të ndryshëm.

Procedimet penale në funksion të të cilëve është vendosur kjo sekuester kanë perfunduar fazën e hetimit paraprak dhe çështja është në gjykim, kështuqë mbajtja e metejshme në sekuester e këtij objekti, që nuk ka asnjë premise që do të konfiskohet në fund të gjyqimit sipas nenit 36 KP, do të ishte e padrejte dhe nuk i shërben aspak këtij procedimi. Kjo sekuestro vetëm sa demton interes të pronarëve të objektit se nuk sjell asnjë të mirë në funksion të këtij procedimi penal. Edhe sikur kjo sekuestro do të ishte e ligjshme dhe do t'i shërbente hetimit të kësaj çështje penale, tani nuk janë me këto kushte sepse ka perfunduar hetimi, ky objekt nuk mund të konfiskohet referuar nenit 36 të K.Penal.

Heqja e sekuestros preventive mbi pasuritë e sekuestruara mbron interesat pasurore të shtetasve që kanë lidhur Kontratë Porosie me shoqërinë, mbron disponimin e lirë të pasurive të paluajshme në përputhje me nenin 1 të Protokollit Shtesë të K.E.D.NJ, nenin 41 dhe 42 të Kushtetutës për garantimin e pronës private dhe disponimin e lirë të pronës së fituar me ligj. Heqja e sekuestros preventive dhe rikthimi i ligjshmërisë së përdorimit dhe disponimit mbi pasuritë që kërkuesi i ka fituar të drejta të ligjshme, janë të drejta civile pasurore, dhe nuk mund të çënojnë procesin penal.

Në këto kushte gjykata vlerëson se, vendimi Nr 135 datë 20.03.2017 që ka vendosur sekuestron preventive për pasuritë e paluajshme, është bërë në përputhje me nenin 274 të K.Pr.Penal në të cilin citohet se:

- " ... Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të 153

lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, ...

- Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal...."

Gjithashtu gjykata, vlerëson se që nga moment i venies së sekuestros rezultoi të ketë ndryshim të kushteve të zbatimit të kesaj mase, për të urdheruar heqjen e sekuestros së venë me vendimin Nr 135 datë 20.03.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe konkretisht ajo është venë në kuadër të procedimit penal për dy vepra të tjera të parashikuara nga kodi penal dhe jo për procedimin penal për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm për të cilin prokurori i është drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq të kerkuesit Shoqëria "SHL" sh.p.k. .

Sa me sipër, gjykata, vlerëson se kërkesa e kerkuesit Shoqëria "SHL" sh.p.k, mbështetet në :

Neni 1 i Protokollit Shtesë të K.E.D.NJ parashikon se çdo person juridik ka të drejtën e gezimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përkundrazi për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës nderkombetare.

Neni 41 i Kushtetutës parashikon se e drejta e pronës private është e garantuar. Ligji mund të parashikojë kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publike.

Neni 42 i Kushtetutës parashikon se prona si e drejte e njohur me Kushtetute dhe me ligj nuk të lirisht të pasurive, në asnjë rast nuk rëndon apo zgjasë pasojat pasi une kerkuesi jam pronare legjitim i pasurive dhe në mënyrë të rregullt ushtrime të aktivitetit.

Neni 274 i K.Pr.Penale parashikon se sekuestroja preventive vendoset kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën

penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera. Gjykata, çmon se heqja e sekuestros preventive mbi pasuritë e sekuestruar mbron interesat pasurore të shtetasve që kanë lidhur Kontrata

Porosie me shoqërinë, mbron disponimin e lirë të pasurive të paluajtshme në përputhje me nenin 1 të Protokollit Shtesë të K.E.D.Nj, nenin

41 dhe 42 të Kushtetutës për garantimin e pronës private dhe disponimin e lirë të pronës së fituar me ligj.

Gjithashtu heqja e sekuestros preventive dhe rikthimi i ligjshmerisë së përdorimit dhe disponimit mbi pasuritë që kerkuesi i ka fituar të

drejta të ligjshme janë të drejta civile pasurore dhe nuk mund të cenohen procesin penal. Venia në dispozicion të aktit të ekspertimit

kontabel dhe shtesës së aktit të ekspertimit kontabel gjatë gjykimit të kesaj kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës mbi të cilën

është provë thelbësore për pranimin e kërkesës pasi çdo e ardhur, shpenzim dhe burim financiar është e justifikuar dhe e fituar në mënyrë të ligjshme.

Për shkak të mësiperme, Gjykata vlerëson se kërkesa e bërë nga kerkuesi Shoqëria "SHL" sh.p.k është e mbështetur në prova

Faqja 3 nga 4

dhe ligj e duhet pranuar.

Për këto arsye

Baza Ligjore:

Në zbatim të nenit nenet 274 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata

VENDOSI:

Vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit Shoqëria "SHL" sh.p.k.
2. Heqjen e masës së sigurimit pasuror “*Sekuestro Preventive*”, të vendosur me vendimin Nr.135 datë 20.03.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me këto të dhëna:
- Objekti "Kompleks banimi” dhe sherbimi Hoteleri, 2 kat nen toke +1 kate sherbimi +2 kat hotel +1 kat sherbim +11 kate banimi+2 kate hotel +2 kate sherbim + Skybar dupleks', qe ndodhet ne vendin e quajtur Shkambi i Kavajes, Lagja nr. 13, Njesia Administrative Rrashbull, Durres.
3. Ngarkohet Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së Parë Durrës në ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dega Durrës.
5. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim brenda 5 (pesë) ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

SHPENZIMET GJYQESORE

Kërkesëpadia 0

Taksa Gjyqësore 200

Noterizime 0

Njoftime 0

Akt ekspertimi 0

Avokat 0

Gjithsej 200

GJYQTAR:

Eda Kaja

Faqja 4 nga 4